

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR ME SELI NE TIRANE
"MARELLI ENERGY" Sh.p.k.

Sot, më datë 09/02/2018, neve personalisht:

- Personi juridik, "**MARELLI LIGHTING**" sh.p.k., shoqëri tregtare shqiptare, me seli ne adresen : Rruga Sikti Çiço, Nr. 2, Bodrum – TIRANE, Njesia Bashkiake nr.2, Shqiperi, e regjistruar ne Qendrën Kombëtare te Regjistrimit, Shqipëri, me NUIS:L41601012R, e përfaqesuar nga **Z. Gianfranco LIUZZI**, i biri i Oronzo-s, lindur me date 06.04.1947 në Locorotondo, Bari (Itali), dhe banues në Tirane, me adresën Rr.Norbert Jokl ,NR 14 banese private Tiranë, Shqiperi, me shtetësi italiane, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar sipas ligjit nëpërmjet Pashaportës italiane me nr. YA 8460575 lëshuar ne date 05/10/2015.

- Personi juridik, "**BLG**" sh.p.k., shoqëri tregtare shqiptare, me seli ne adresen: Rruga Tercilio Kardinali , Nd 10,Kati i 2, Shk 1, Ap 2 – TIRANE, Njesia bashkiake nr 11, Shqiperi, e regjistruar ne Qendrën Kombëtare te Regjistrimit, Shqipëri, me NUIS: L71603025P, e përfaqesuar nga **Z. Massimiliano NICOLINI**, lindur me datë 16/11/1976 në Brescia, Itali, banues në adresën : Rruga Princ Vidi, Tiranë, Shqipëri, me shtetësi italiane, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar sipas ligjit nëpërmjet Pashaportës italiane me Nr. YA1831944 lëshuar në datë 02/03/2011.

- Personi juridik, "**HSD ALBANIA**" sh.p.k., shoqëri tregtare shqiptare, me seli ne adresen :Lagjja Fushe-Mezez, Autostrada Tirane-Durres, Km 1, Rruga dytesore ne godinen Terminal Center, Nr.Pasurise 66/51-N7, vol.29, fq.200, Tirane Kashar MEZEZ, Z.Kadastrale Nr.2679 Shqiperi, e regjistruar ne Qendrën Kombëtare te Regjistrimit, Shqipëri, me NUIS: L72122010E, e përfaqesuar nga **Z. Germano VENTURA**, lindur me date 16.06.1967 ne Benevento,Itali, dhe banues ne Tirane, me adresen Lagjja Fushe-Mezez, Autostrada Tirane-Durres, Km 1, Rruga dytesore ne godinen Terminal Center, Tirane, Shqiperi, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar sipas ligjit nëpërmjet Pashaportës italiane me nr. YA0862613 lëshuar ne date 09.07.2010.

Neni 1

Te themelojnë Shoqërinë Tregtare "**MARELLI ENERGY**" Sh.p.k. në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria kundrejtuar të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri "**MARELLI ENERGY**" Sh.p.k. sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe Statut.

Neni 2: Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktivitetit ekonomik në fusha të ndryshme. Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë thellësisht me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

Neni 3: Emri dhe vula e Shoqërisë.

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko – civil me emrin "**MARELLI ENERGY**" Sh.p.k. Ajo do të ketë edhe vulën e saj.



Neni 4: Objekti i veprimtarisë.

Shoqëria do të ushtrojë aktivitet privat në fushën e :

Konsulencës, kërkimit, zhvillimit dhe inovacionit teknologjik në kuadrin e rregulloreve të parashikuara në zbatimin e Fondeve Strukturore Evropiane, të menaxhuara drejtpërdrejtë ose sipas parimit të subsidiaritetit nga organet kompetente.

Në veçanti, projekt propozimet dhe planet e kërkimit dhe zhvillimit të sipërmarrjes do të fokusohen veçanërisht në fushat vijuese: Këshillim në favor të Organeve publike dhe private kombëtare dhe ndërkombëtare në planifikimin dhe menaxhimin e planeve të ndërhyrjes në sektorin e teknologjive të përparuara dhe të energjisë së rinovueshme. Zhvillimi i instrumenteve, metodave dhe modeleve për vlerësimin e problemeve kryesore ekonomike dhe shoqërore të lidhura me teknologjitë energjitike dhe ofrimi i objektivave sasiore dhe i skenarëve afatmesëm dhe afatgjatë, duke përfshirë edhe mbështetjen shkencore në hartimin e politikave.

Zbatimi, në bashkëpunim me Universitete dhe Qendra studimi kombëtare dhe ndërkombëtare, të aktiviteteve trajnuese në sektorët e mëposhtëm:

- Shëndetësor
- Produkteve ushqimore, bujqësore dhe bioteknologjike
- Teknologjitë e informacionit dhe komunikimit
- Nanoshkencave, nanoteknologjive, teknologjive të materialeve dhe proceseve të prodhimit.
- Energjisë
- Mjedisit (duke përfshirë ndryshimet klimatike)
- Transportit (përfshirë aeronautikën)
- Trajnim i vazhdueshëm dhe zhvillim i karrierës – Bursa studimi individuale
- Ndërlidhjet e partneriteteve të përbashkëta industri-universitet
- Dimensioi ndërkombëtar - bursa studimi në dalje dhe në hyrje, mekanizmi i bashkëpunimit ndërkombëtar, kontributi për riintegrim
- Çmime për ekselencën

Aktivizimi i infrastrukturës në mbështetje të aktiviteteve të mëposhtme:

- Kërkime në favor të PMI-ve
- Rajonet e dijes
- Potenciali i kërkimit
- Shkenca në shoqëri
- Mbështetje në zhvillimin koherent të politikave të kërkimit
- Aktivitete të veçanta të bashkëpunimit ndërkombëtar

Shoqëria gjithashtu do të kujdeset për:

Projektimin, ndërtimin, riorganizimin dhe menaxhimin e të gjithë veprave civile (diga, ura, kanale, rezervuare, etj), makinerive, impjanteve dhe pajisjeve elektronike për central hidroelektrike, të erës dhe fotovoltaike për prodhimin e energjisë së gjelbër.

Rehabilitimi të gjitha pajisjeve tashmë në përdorim në të gjitha centralet e të gjitha llojeve për prodhimin të energjisë elektrike duke përfshirë turbinat, gjeneratorët, panelet elektrike dhe

elektronike për kontroll. Projektimi dhe prodhimi i tubave dhe i pajisjeve të tjera mekanike dhe hidraulike rreth centraleve të prodhimit të energjisë elektrike.

Hartimi dhe prodhimi i makinerive dhe i pajisjeve, deri në zhvillimin e rrjeteve të energjise së integruar evropiane.

Kërkimin, zhvillimin dhe pasqyrimin e teknologjive për të rritur efektivitetin, sigurinë, besueshmërinë dhe cilësinë e rrjeteve dhe të sistemeve evropiane të gazit dhe energjisë elektrike, veçanërisht në fushën e tregut të integruar evropian të energjisë.

Projektimi dhe prodhimi i makinerive dhe i pajisjeve për prodhimin dhe kursimin e energjisë. Kërkimi, zhvillimi dhe shfaqja e koncepteve të reja, përmirësimi i koncepteve dhe i teknologjive të kontrolluara për të rritur prodhimin e energjisë dhe për të përfituar nga kursimet e mëvonshme të konsumit final dhe fillestar të energjisë, gjatë ciklit përkatës jetësor të ndërtesave (duke përfshirë ndriçimin), transportin, shërbimeve dhe në sektorin industrial, përfshirë integrimin e strategjive dhe teknologjive të efijencës së energjisë, përdorimin e teknologjive të reja energjitike dhe të rinovueshme, me një ndikim minimal në klimë.

Eksperimentimi, projektimi, prodhimi dhe asistenca teknike e makinerive dhe e pajisjeve të dizenuara për të zhvilluar sektorine transportit elektrik.

Importimi - eksportimi dhe tregtim e të gjitha pajisjeve, makinerive, aksesorëve që kanë të bëjnë me objektin e aktivitetit.

Shoqëria gjithashtu mund të kryejë aktivitete të tjera të lejuara nga ligji në fuqi për këtë lloj shoqërie, në bashkëpunim me shoqëri dhe Organe publike dhe private, kombëtare dhe ndërkombëtare, në Shqipëri dhe jashtë vendit, edhe me pjesëmarrja apo perfaqësimi në shoqëri të ndryshme shqiptare apo të huaja që kanë objekt të njejtë apo të përafërt me atë të kësaj shoqërie.

Neni 5: Selia e Shoqërisë dhe Afati

Selia e Shoqërisë ndodhet në Tiranë, në adresën: **Rruga Fadil Rada, nr. 3 banese private – Njesia Administrative nr.2 - 1017 Tiranë (Shqiperi)**. Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një periudhë kohore pa afat.

Neni 6: Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar është **1.000.000 (një milion) Lek** dhe zotërohet nga ortakët themeluesve :

Vlera totale e kapitalit të regjistruar : 1.000.000

Vlera e paguar : 1.000.000

Numri total i kuotave 3

Kapitali themeltar është mbuluar tërësisht nga ortakët themelues.

Neni 7: Ortak themelues

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e Shoqërisë Tregtare "**MARELLI ENERGY**" Sh.p.k. është në përputhje me kontributet e tyre si më poshtë:

1. Ortaku themelues **MARELLI Lighting sh.p.k. 51% - 1 kuote**
2. Ortaku themelues **BLG 10% - 1 kuote**
3. Ortaku themelues **HSD 39% - 1 kuote**

Kuota lloji I kontributit : **Cash**

Vlera e kontributit 1.000.000 Leke

Pjesa e zoterimit te kapitalit te shoqerise 100%

Vlera Totale e Kapitalit te regjistruar : 1.000.000 Leke(njëmilion).

Neni 8: Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr.9901, date 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asamblea e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori/ët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Neni 9: Administratori

Shoqëria administrohet nga ana e Administratorit/ëve të cilët zgjidhen për një mandat 5 (pesë) vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Administrator i parë i shoqërisë do të jetë **Z. Gianfranco LIUZZI**, i biri i Oronzo-s, i datëlindjes 06.04.1947, shtetas italian, lindur në Locorotondo, Bari (Itali) dhe banues në Tirane, me adresën Rr.Norbert Jokl, NR 14 banese private – Tirane (Shqiperi) person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i pashaportës italiane me nr. YA 8460575 leshuar ne date 05/10/2015.

Shoqëria përfaqësohet para cdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 10: Pjesmarrjen në Shoqëri

Ortakët themelues mund të vendos me vullnetin e tij, për pjesmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojë cdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

Neni 11: Sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë

Ortaku detyrohet të ruaj sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punesuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhduken Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre.

Neni 12: Mosmarrveshjet

Mosmarrveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen nga ortak themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.



Neni 13: Nënshkrimi Akti i themelimit

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortakët themelues u gjet sipas vullnetit të tyre dhe u nënshkrua pa vërejtje.

Akti i Themelimit hartohet në gjuhën shqipe.

Emrat dhe nënshkrimet e Ortakëve Themelues:

ORTAKET THEMELUES

MARELLI Lighting sh.p.k.
Administrator :
Gianfranco LIUZZI

Gianfranco Liuzzi
Marelli

PERKTHYES:

*veç sipas ve
Etablisht*
Uedgyf



HSD ALBANIA shpk
Administrator :
Germano Ventura

Germano Ventura

HSD ALBANIA SHPK
L72122010E
TIRANE

Tiranë 09/02/2018